



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË

**PROJEKTVENDIM**

Nr 5217, Datë 28/03 / 2021

**Për një shtesë dhe ndryshim në buxhetin e Bashkisë Lezhë për vitin 2021**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjes Vendore”; të ligjit nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetë qeverisjes vendore”; të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të VKM nr.110, datë 24.02.2021, VKM nr. 149, datë 10.03.2021; të Udhëzimit Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.9, date 20.03.2018 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit”; dhe të shkresës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.3572/2, date 08.03.2021 “Mbi zbatimin e VKM-së nr.70, datë 03.02.2021, Kryetari i Bashkisë i paraqet projektin përkatës Këshillit të Bashkisë,

**Për të vendosur :**

1. Miratimin e një shtesë në buxhetin e bashkisë për vitin 2021 si më poshtë:

1/1-Të shtohen burimet në buxhetin e vitit 2021 në shumën 78,088,867 lekë.

2/2-Të shtohet shpenzimet në programin buxhetor “Planifikimi Urban Vendor” në shumën 78,088,867 lekë . Veprimet të kryhen si më poshtë :

- Pakësohet : Gr.00, Prog.04960, Kap.01, Art.604 në shumën 78,088,867 lekë.
- Shtohet : Gr.00, Prog.06140, Kap.01, Art.231 në shumën 78,088,867 lekë si me poshte :
  - ✓ Punime te ndertimit te objektit : 76 621 244 lekë
  - ✓ Mbikqyrja e punimeve : 1 384 550 lekë
  - ✓ Kolaudimi dhe pergattija e dokumentacionit perfundimtar : 83 073 lekë

2.Për zbatimin e këtij vendimi ngakohet Kryetari i Bashkisë.

3.Ky vendim hyn fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETARI**

**Pjerin NDREU**

